



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 578/1
prot

Shkoder, më 11.03.2025

LËNDA: Mbi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Fushë Arrëz Nr.29, datë 27.08.2025.

KËSHILLIT BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 18, 24, neni 54 germa k, neni 55/2, ligjit Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH" neni 36 pika 1/c, VKM Nr.111/2018 "Per krijimin dhe funksionimin e fondit social", dokumentacionit të sekretarit të KB, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Fushë Arrëz Nr.29, datë 27.08.2025 "Mbi miratimin e planit social vendor në Bashkinë Fushë Arrëz për 2025-2028".

Prefekti konstaton se në mbështetje të ligjit Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" neni 36 pika 1/c, Këshilli Bashkiak ka tagrin të miratojë një plan social vendor¹.

Për sa trajtuar, referuar Urdhërit të Prefektit për delegim Nr.62, datë 28.08.2025, ju autorizohet të procedohet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI

NË MUNGESË DHE DELEGIM

NËNPREFEKTI

Hysen HYSAJ

¹ Sipas propozimit të organit ekzekutiv



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2657 prot.

Fushë-Arrëz, më 2.09.2025

VENDIM

Nr. 29, datë 27.08.2025

"PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ 2025-2028"

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjit 9669 datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, VKM nr.334 datë 17.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"; Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"; neni 36 i Ligjit nr.121, datë 21.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e Llogaritjes së Fondeve për Financimin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror", pika 11; shkresën nr. 2171, datë 15.04.2019 Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit; Projektit dhe Relacionit të paraqitur nga Administrata e Bashkisë Fushë-Arrëz me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e datës 27.08.2025, pas shqyrtimit,

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Social Vendor të Bashkisë Fushë-Arrëz 2025-2028, sipas Planit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Sociale; Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe personat përgjegjës sipas zyrave përkatëse.
3. Ky vendim u zbardh me datë 2.09.2025 dhe hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz me:

10 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU





BASHKIA FUSHË-ARRËZ

PLANI SOCIAL VENDOR
2025–2028

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 29, datë 27.08.2025



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbytja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike "Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU4SD), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Fushë-Arrëz, zbatuar nga GOPA Eorldëide Consultants.

Shkurtime

AK	Aftësi të Kufizuara
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizat Jo Qeveritare
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
NE	Ndihmë Ekonomike
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVRN	Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
QSNNN	Shoqata "Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë" Fushë-Arrëz
PSV	Plani Social Vendor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UM	Urdhër Mbrojtje

Contents

I. Hyrje	4Error! Bookmark not defined.
II Metodologjia.....	5Error! Bookmark not defined.
III. Diagnoza për shërbimet shoqërore.....	6Error! Bookmark not defined.
IV. Burimet njerëzore.....	Error! Bookmark not defined.
V. Analiza SËOT.....	Error! Bookmark not defined.
VI.Parimet, vizioni, misioni dhe qëllimi i planit.....	Error! Bookmark not defined.
VII. Prioritetet dhe objektivat specifike	Error! Bookmark not defined.
VIII. Plani i Veprimt	Error! Bookmark not defined.
IX. Monitorimi dhe vlerësimi.....	Error! Bookmark not defined.
X. Aneks.....	Error! Bookmark not defined.
Aneksi 1. Kuadri Legjislativ.....	46
Aneksi 2. Të dhëna statistikore për grupet vulnerabël	46

I. Hyrje

Bashkia Fushë-Arrëz, e vendosur në pjesën veriore të Shqipërisë, përfshin një territor malor me pasuri të konsiderueshme natyrore, pyje të dendura, burime ujore dhe peizazhe tërheqëse, që ofrojnë potencial të madh për zhvillim të qëndrueshëm në turizëm, bujqësi, energji të pastër dhe industri përpunuese. Megjithatë, sfida si izolimi gjeografik, largësia nga qendrat urbane dhe mungesa e shërbimeve të strukturuar sociale kërkojnë ndërhyrje të menduara dhe një angazhim të qartë institucional për garantimin e mirëqenies dhe barazisë sociale.

Plani Social Vendor i Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025–2028 është ndërtuar mbi një vizion të qartë për ndërtimin e një bashkie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për të jetuar me dinjitet dhe për të qenë pjesë aktive e zhvillimit komunitar. Dokumenti është hartuar në përputhje me luadrin ligjor në fuqi dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, përmes një procesi të orientuar nga vetë bashkia.

Plani përmban tri prioritetet strategjike:

- ❖ Zhvillimi i shërbimeve sociale të strukturuar dhe të specializuara për grupet në nevojë;
- ❖ Përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i individëve vulnerabël përmes aftësimit, punësimit dhe pjesëmarrjes në zhvillimin lokal;
- ❖ Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe forcimi i partneriteteve për një sistem të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale.

Analiza SËOT ka evidentuar si avantazh pasuritë natyrore dhe përvojën pozitive të bashkisë në zbatimin e projekteve sociale, por gjithashtu ka nxjerrë në pah sfida të rëndësishme si mungesa e të dhënave të detajuara, kapacitetet e kufizuara dhe fragmentimi institucional në mbrojtje sociale.

Ky plan shërben si një instrument strategjik për zhvillim dhe barazi sociale, duke ndërthurur planifikimin social me potencialin ekonomik dhe natyror të territorit. Zbatimi i suksesshëm i tij kërkon mobilizimin e burimeve vendore dhe kombëtare, partneritete të forta dhe përkushtim të vazhdueshëm për t'i sjellë qytetarëve ndryshime të prekshme në jetën e përditshme.


familje janë larguar, të rinjtë kërkojnë mundësi diku tjetër (jashtë bashkisë), dhe regjistrat civilë nuk e kapin gjithmonë këtë ndryshim të heshtur që po ndodh në komunitet.

Shpërndarja territoriale dhe ndryshimet demografike sipas njësive administrative

Të dhënat e paraqitura nga Bashkia evidentojnë qartë tendencën drejt përqendrimit të popullsisë në zonën qendrore të bashkisë, dhe nevojën për politika aktive për të frenuar boshatisjen e njësive periferike.

Figura 2 më poshtë pasqyron ndryshimet e popullsisë në periudhën 2022–2024 sipas njësive administrative. Ajo vë në dukje rënien e ndjeshme të popullsisë në Qafë Mali dhe rritjen e lehtë në Fushë-Arrëz, ndërsa njësitë e tjera shfaqin qëndrueshmëri relative ose rënie modeste. Të dhënat konfirmojnë tendencën drejt përqendrimit të popullsisë në njësinë qendrore dhe zbrazjen e zonave më të thella.

Figura 2: Ndryshimi i popullsisë 2022–2024 sipas njësive administrative



Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2022–2024

Struktura sipas grupmoshave (Cens 2023)

Struktura e grupmoshave sipas Censit 2023 tregon për një popullsi në plakje, me përqindje të ulët të fëmijëve dhe të lartë të të moshuarve (fig 4). Kjo përbën një sfidë për politikat sociale dhe ekonomike të bashkisë, veçanërisht në planifikimin afatgjatë të shërbimeve shoqërore.

Figura 4: Struktura e grupmoshës së popullsisë

Grupmosha	Numri	Përqindja
0–14 vjeç	619	13%

15-64 vjeç	3,455	71%
65+ vjeç	804	16%
Total	4,878	100%

Burimi: Cens 2023

Konkluzione dhe ndikimi në planifikimin social

Nga analiza demografike dalin në pah disa elementë kyç që duhet të merren parasysh në Planin Social Vendor:

- ✓ Migracion i lartë dhe boshatisje e zonave rurale, veçanërisht në Qafë Mali dhe Blerim.
- ✓ Plakje e popullsisë, që kërkon ndërhyrje specifike për kujdesin ndaj të moshuarve.
- ✓ Numër i ulët i fëmijëve, që prezanton për tkurrje të potencialit demografik afatgjatë.
- ✓ Mospërputhje mes popullsisë së regjistruar dhe asaj reale, çka kërkon rivlerësim të politikave dhe ndërtim të databazave funksionale për shërbimet sociale.
- ✓ Përqendrim i popullsisë në njësinë Fushë-Arrëz, që kërkon balancim të zhvillimit territorial.

Të dhënat demografike për Bashkinë Fushë-Arrëz nxjerrin në pah një situatë të ndërlikuar, ku përveç migracionit dhe plakjes së popullsisë, zhvillimi i pabarabartë territorial kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të garantuar akses dhe barazi në shërbime. Planifikimi social duhet të bazohet mbi këto realitete, duke synuar ngritjen dhe forcimin e shërbimeve në terren, uljen e largimeve nga bashkia, si dhe ofrimin e politikave sociale me fokus fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit

2. Diagnoza e familjeve në nevojë

Diagnoza paraqet situatën e familjeve në nevojë në Bashkinë Fushë-Arrëz, e mbështetur në të dhënat administrative të skemës së Ndihmës Ekonomike për vitin 2024, për shkak të mungesës së një databaze gjithëpërfshirëse për të gjitha familjet në vështirësi. Analiza eidenton vështirësi ekonomike dhe mangësi në shërbimet bazë, si dhe numër të lartë të familjeve në nevojë në disa njësi administrative. Aktualisht, mbështetja bazohet kryesisht nga pagesat e NE, ndërsa mungojnë shërbime sociale të integruara (këshillim psiko-social, mbështetje për punësim, ndërhyrje në komunitet), gjë që kufizon ndikimin afatgjatë të mbështetjes sociale tek familjet në nevojë.

Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Në mungesë të një databaze të plotë për identifikimin e familjeve në nevojë, diagnoza e situatës sociale në Bashkinë Fushë-Arrëz bazohet në të dhënat e skemës së ndihmës ekonomike, të cilat përbëjnë një nga shtresat më të pambrojtura të komunitetit. Këto familje përballen me vështirësi të mëdha ekonomike, mungesë të të ardhurave të qëndrueshme dhe akses të kufizuar në shërbime bazë. Territori malor, izolimi gjeografik dhe mungesa e mundësive për punësim apo vetëpunësim e përkeqësojnë më tej situatën sociale të këtyre familjeve, duke i ekspozuar ndaj riskut të varfërisë së trashëguar.


Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në maj 2024, nga 3018 familje që ka Bashkia, vetëm 306 familje evidentohen në nevojë dhe mbështeten me një pagesë mujore në lek, Ndihmë Ekonomike (NE), 289 familje janë përfituese të ndihmës ekonomike dhe 17 familje janë fituese nga skema e Fondit 6%. Familjet përfituese nga të skemat së bashku, përbëjnë rreth 10.14% të familjeve në nivel bashkie. Nga totali prej 4874 banorësh (sipas Censit 2023), 1217 banorë janë anëtarë të familjeve përfituese të NE, dhe përbëjnë afro 25% e popullsisë në nivel bashkie. Të dhënat eidentojnë përqëndrimin e varfërisë tek familjet përfituese të NE dhe mungesa e një databaze gjithëpërfshirëse rrit rrezikun e mosregjistrimit të rasteve të tjera në nevojë.

Pesha e lartë e popullsisë brënda familjeve përfituese nënvizon përqëndrimin e varfërisë në këto amvisëri, ndërkohë që, për shkak të mungesës së një databaze gjithëpërfshirëse, rreziku i nënidentifikimit të familjeve në nevojë mbetet i pranishëm. Kjo tregon për një përqëndrim të dukshëm të varfërisë brënda këtyre familjeve, ndërkohë që numri real i familjeve në nevojë mund të jetë më i lartë, por i paidentifikuar.

Të dhënat mbi përfituesit e ndihmës nga skema e NE tregojnë një rënie progresive të familjeve përfituese të saj nga 358 familje në maj 2022 në 289 në maj 2024 pasqyruar në fig.5


Figura 5 Tredi i familjeve përfituese të Ndihmës Ekonomike (NE) në vite



Burimi: Bashkia Fushë - Arrëz 2022-2024

Shpërndarja e familjeve përfutuese të Ndihmës Ekonomike tregon ngarkesë të lartë në Fierzë (77) dhe Iballë (73), me mbi gjysmën e totalit prej 289 familjesh të përqendruara në këto dy Njësi Administrative; Qafë Mali (50) dhe Blerim (45) paraqesin ngarkesë mesatare, ndërsa Fushë-Arrëz ka nivelin më të ulët (44), shiko figurën 6. Duke u nisur nga kjo shpërndarje, shërbimet shoqërore duhet të vendosen sipas territorit: prani më e madhe e ekipit social në Fierzë dhe Iballë, mbështetje e fokusuar në Qafë Mali dhe Blerim, si dhe monitorim i rregullt nga qendra bashkiake (Fushë-Arrëz).

Figura 6: Numri i familjeve përfutuese të NE sipas Njësive Administrative




Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024

Sipas të dhënave administrative të NE, gjatë periudhës së analizuar:

- 289 familje përfitojnë Ndihmë Ekonomike; brenda tyre numërohen 415 fëmijë dhe 145 të moshuar mbi 65 vjeç. Kjo përbërje demografike e vërteton se një pjesë e konsiderueshme e varfërisë bie mbi familjet me fëmijë, ndërsa prania e lartë e të moshuarve kërkon mbështetje të posaçme për kushtet e jetesës dhe kujdesin në familje, përtej pagesës së NE.
- Nuk ka përfutues nga kategoritë: jetimë, viktime të dhunës/trafikimit dhe prindër me lindje të shumëfishta.
- Nga ana tjetër, Bashkia nuk disponon të dhëna mbi gjendjen e banesave apo nevojat për përkrahje afatgjatë të familjeve në nevojë. Këto mungesa nënvizojnë boshllëqe të rëndësishme në identifikimin dhe kategorizimin e nevojave reale të familjeve brenda dhe jashtë skemës së NE.

Figura 7, më poshtë, sintetizon strukturën e familjeve përfituese të NE sipas madhësisë (shtator 2024) dhe e plotëson panoramën e përshkruar më sipër

Figura 7: Struktura e familjeve përfituese të NE shtator 2024



Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz Shtator 2024

Fig 6 tregon se pjesa më e madhe e përfituesve përbëhet nga familje me 3-5 anëtarë, ndërsa familjet me një person zënë një pjesë jo të vogël dhe përbëjnë grup me rrezik social. Familjet me 6 ose më shumë anëtarë janë më pak të shpeshta, por kanë nevojë më të mëdha për mbështetje të integruar, çka kërkon masa të diferencuara sipas përbërjes familjare.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Ndihma ekonomike mbetet forma kryesore e mbështetjes për familjet në nevojë në Bashkinë Fushë-Arrëz. Si në qendrën e bashkisë ashtu edhe në njësitë administrative mungojnë shërbimet e mirëfillta të kujdesit shoqëror (qendra ditore/komunitare, këshillim psiko-social, programe pas-shkollore, ndërhyrje rehabilituese); administratorët shoqërorë janë kanali i vetëm i kontaktit, por me kapacitete të kufizuara. Në vitin 2024, ndër 289 familje përfituese të NE u identifikuan 70 familje me situatë sociale (30 me anëtarë me AK, 25 me kryefamiljarë në moshë pensioni, 10 gra kryefamiljare, 5 vajza-nëna). Megjithatë mbështetja në cash nuk u shoqërua me shërbime të specializuara dhe afatgjata. Në territor po zbatohen projekte që axisin përfshirjen dhe aftësimin, duke orientuar familjet drejt punësimit dhe fuqizimit ekonomik, si bazë për zhvillimin e shërbimeve më të qëndrueshme në komunitet.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bashkia Fushë-Arrëz ka nevojë për ndërhyrje të strukturuar për të garantuar identifikimin, mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve në nevojë përtej skemës së ndihmës ekonomike. Ndërhyrjet prioritare përfshijnë:

- ✓ Ngritja e një databaze për evidentimin e të gjitha familjeve në vështirësi ekonomike, përfshirë ato që nuk përfitojnë aktualisht NE.
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve komunitare për ofrimin e ndihmës psiko-sociale, asistencë në strehim dhe trajnime për vetëpunësim.
- ✓ Rritja e kapaciteteve të sektorit social dhe administratorëve për të ndjekur dhe monitoruar rastet në nevojë.
- ✓ Zgjerimi i mbështetjes për kategoritë më të marginalizuara si vajzat nëna, PAK, dhe gratë kryefamiljare.

Profili social i familjeve në nevojë në Bashkinë Fushë-Arrëz shënon varësi të lartë nga Ndihma Ekonomike, mungesë shërbimesh shoqërore të strukturuar në nivel qendror dhe njësisht administrative, si edhe pabarazi territoriale të ngarkesës; megjithatë, rrjeti arsimor dhe komunitar, së bashku me projektet aktive në territor, tregojnë potencial real për rritje të aksesit dhe cilësisë së mbështetjes për individët dhe familjet në nevojë. Forcimi i bazës së të dhënave dhe rritja e kapaciteteve të stafit social mundëson targetim më të saktë të familjeve me risk dhe orienton investimet drejt zgjidhjeve të qëndrueshme në komunitet.

3. Diagnoza për personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Kjo diagnozë jep një pamje të qartë e të përqendruar për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Fushë-Arrëz, duke evidentuar larinë e nevojave, dallimet territoriale dhe pjesëmarrjen ende të brishtë në arsim e jetë komunitare. Ajo vë në pah boshllëqet në mbështetje pranë vendbanimit dhe mungesën e një zinxhiri shërbimesh të strukturuar, ndërkohë që përcakton drejtimit praktike për përmirësim në përputhje me kuadrin ligjor dhe parimet e përfshirjes. Në thelb, dokumenti kthen gjetjet në orientime të zbatueshme (nga ofrimi i shërbimeve afër qytetarit të bashkërendimi me partnerët) duke hapur rrugën për rritje të aksesit, cilësisë dhe pjesëmarrjes.

Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) në Bashkinë Fushë-Arrëz përfshijnë fëmijë dhe të rritur me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar (motorike, shqisore, intelektuale/zhvillimore, psikosociale dhe të kombinuara) të pranishëm në të gjitha njësitë administrative. Mbështetja për to duhet të jetë e personalizuar, duke siguruar akses fizik e komunikues, shërbime rehabilituese dhe përfshirje arsimore të vazhduar, veçanërisht në kalimet ndërmjet niveleve arsimore (nga parashkollor tek arsimi bazë, nga arsimi i mesëm tek i larti, profesional), përmes masave si transport i përshtatur, mësues ndihmës dhe përshtatje didaktike, si dhe pjesëmarrje aktive në jetën komunitare.

Sfidat kryesore lidhen me mungesën e shërbimeve shoqërore të strukturuar në nivel vendor, varësinë nga ofrues jopublikë dhe boshllëqet në të dhëat për shërbimet e marra, si dhe me largësinë nga shërbimet e specializuara jashtë bashkisë. Këto sfida duhen adresuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Konventa e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), të cilat kërkojnë akses, shërbime të përshtatura dhe përfshirje të plotë në nivel vendor. Ky sesion shërben si bazë diagnostike që orienton objektivat, prioritetet dhe masat e planit.

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Numri i personave që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar (AK) është 352, i njëjti në dy vitet e fundit (2023–2024). Me referencë Regjistrin Civil 2024, kjo përbën 3.29% të popullsisë së Bashkisë Fushë-Arrëz. Bashkia nuk raporton të dhëna për vitet pararendëse (p.sh. 2022), ndaj vlerësimi i trendit shumëvjeçar nuk është i mundur në këtë fazë.

Shpërndarja sipas llojit të aftësisë së kufizuar tregon peshë të lartë të “PAK të tjerë” dhe “invalidë”, ndërsa “të verbër” dhe “para/tetraplegjikë” kanë prevalencë më të ulët. Ky profil nënkupton nevoja të theksuara për mbështetje të zgjatur, përshtatje funksionale dhe ndërhyrje rehabilituese për grupet dominante, si dhe zgjidhje të targetuara (pajisje ndihmëse, orientim drejt shërbimeve të specializuara) për grupet me prevalencë më të ulët (shih figurën 8).




Figura 8 Përbërja e PAK sipas llojit të AK (numra)./ Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024

Në planin territorial, ndonëse Fushë-Arrëz ka numrin më të lartë absolut të PAK, raportet ndaj popullsisë janë më të larta në: Qafë Mali 4.84%; Fierzë 4.61%; Iballë 3.75%; Blerim

2.97%; Fushë-Arrëz 2.45%. Kjo sugjeron prioritet për shtrirjen e mbulimit dhe kontakt të drejtpërdrejtë me familjet në këto njësi, për të balancuar qasjen dhe afërsinë me shërbimet (shih figurën 9).




Figura 9. Raporti i PAK ndaj popullsisë sipas njësive administrative (Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024 dhe Regjistri Civil 2024).

Të gjithë PAK marrin pagesën bazë për shkak të AK, ndërsa "ndihmësi personal" përfitohet nga 70 persona (rreth një e pesta e totalit) (shih figurën 10).




Figura 10. Mbeshtetja me ndihmë personal (numër PAK). Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024

Përfshirja arsimore mbetet e ulët: numri i PAK që ndjekin arsimin e mesëm është i kufizuar dhe në arsimin e lartë nuk ka asnjë ndjekës, pavarësisht ekzistencës së

instrumenteve nxitëse; barriera praktike për vijimësi në ciklet e larta mbeten të forta. Aktualisht, bashkia nuk ofron shërbime shoqërore të strukturuar për PAK.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Peizazhi i shërbimeve për PAK në Bashkinë Fushë-Arrëz karakterizohet nga mungesa e shërbimeve shoqërore të strukturuar në nivel vendor. Mbështetja aktuale mbështetet kryesisht në pagesën bazë për shkak të aftësisë së kufizuar dhe në një numër të kufizuar rastesh me ndihmës personal. Pjesa tjetër e nevojave (rehabilituese, ditore, komunitare apo në familje) adresohet kryesisht jashtë territorit (p.sh., në Shkodër) ose nga ofrues jopublikë (p.sh., komunitete fetare), gjë që e kushtëzon qasjen me largësinë dhe kostot e lëvizjes.

Në aspektin e mbulimit, të gjithë personat e evidentuar marrin pagesën bazë për AK (352 nga 352), por shërbimi i ndihmës personal mbetet i kufizuar: vetëm 70 persona, rreth 19.9% e PAK, e përfitojnë këtë formë përkujdesjeje dhe vetëm me vendim të komisioneve përkatëse. Kjo tregon se mbështetja me kujdes të përditshëm të strukturuar nuk është universale dhe se një pjesë e konsiderueshme e rasteve mund të mbeten pa shërbime të përshtatura pranë vendbanimit.

Shërbimet komunitare/ditore dhe ndërhyrjet në familje nuk rezultojnë të organizuara në nivel bashkie; rrjedhimisht, nuk ekziston një zinxhir i plotë shërbimesh që të sigurojë vijimësi të kujdesit nga identifikimi i nevojës deri te rehabilitimi dhe përfshirja sociale. Mbulimi territorial nuk mund të vlerësohet me saktësi, pasi bashkia nuk raporton shpërndarjen e përfitimeve dhe shërbimeve sipas njësive administrative dhe mungon një evidencë e standardizuar për shërbimet e ofruara nga ofruesit jopublikë (tipologji, frekuencë, përfitues unikë).

Në thelb, oferta aktuale përqendrohet te mbështetja financiare dhe një komponent i kufizuar i kujdesit personal, ndërsa shërbimet sociale të bazuara në komunitet (të nevojshme për autonomi, rehabilitim dhe përfshirje) mungojnë. Kjo krijon boshllëqe në akses, kontinuitet dhe cilësi, veçanërisht për PAK që banojnë larg qendrës bashkiake dhe për familjet me kapacitete të kufizuara për të përballuar koston dhe kohën e udhëtimit.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në Sesionin 1, 2 dhe 3, nevojat prioritare fokusohen në:

- Paketë bazë shërbimesh në komunitet që parashikon hapjen e një shërbimi shoqëror në Fushë-Arrëz që ofron informim dhe këshillim, shërbim ditore me komponent rehabilitues të lehtë dhe ndërhyrje në familje.
- Shtrirje e mbulimit të shërbimit nëpërmjet shërbimit lëvizës në të gjitha njësitë administrative.

- Akses dhe lehtësim transporti me zbatim të një skeme lehtësuese për transport dhe akomodim gjatë përdorimit të shërbimeve jashtë bashkisë, me orientim për pajisje ndihmëse dhe përshtatje të vogla në banesë kur është e nevojshme.
- Përfshirja arsimore përmes një mekanizmi bashkërendues me institucionet arsimore për identifikim të hershëm, përshtatje didaktike dhe ndjekje të vijimësisë nga arsimi bazë në të mesëm duke adresuar pengesat praktike për vijimësi.
- Partneritet me ofrues jopublikë me marrëveshje bashkëpunimi për shërbime specifike si fizioterapi dhe këshillim dhe me standard raportimi për frekuencën dhe përfituesit unikë.
- Kapacitete dhe trajnime përmes trajnimit të stafit të sektorit social në vlerësim biopsikosocial, menaxhim rasti dhe koordinim ndërinstitucional të shoqëruar me udhëzues të brendshëm për rrjedhat e punës.
- Infrastrukturë e aksesueshme me përshtatje të vogla në hapësirat publike dhe në pikën e shërbimit si rampa dhe orientim/komunikim i aksesueshëm në përputhje me standardet e aksesueshmërisë.

Personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Fushë-Arrëz kanë nevojë të larmishme dhe qasje të pabarabartë ndaj mbështetjes, ndërsa shërbimet e strukturuar pranë vendbanimit mungojnë. Prioritet mbetet afrimi i shërbimeve në komunitet, shërbimi lëvizës në njësitë me ngarkesë më të lartë, menaxhimi i rasteve dhe partneritetet me ofrues jopublikë. Forcimi i regjistrimit të të dhënave dhe bashkërendimi me sistemin arsimor rrisin vijimësinë dhe cilësinë e kujdesit. Me këto hapa, bashkia vendos bazat për një sistem më të aksesueshëm, gjithëpërfshirës dhe efektiv për PAK.

4. Diagnoza e fëmijëve në nevojë

Legjislacioni shqiptar, konsideron fëmijë, çdo person nën 18 vjeç. Aktualisht, bashkia nuk ka një structure të veçantë për evidentimin sistematik të fëmijëve në nevojë ose në rrezik, dhe roli i punonjësit/NJMF nuk është i qartë. Bashkia, grupet me rrezik më të lartë konsideron fëmijët që jetojnë në familje përfutuese të Ndihmës Ekonomike (NE) dhe fëmijët me aftësi të kufizuara (AK).

Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore (pa të dhëna numerike)


Në Bashkinë Fushë-Arrëz, fëmijët rriten në komunitete të vogla ku shkollat dhe kopshtet luajnë rolin e qendrave të përfshirjes së përditshme dhe mbështetjes sociale. Sfidat lidhen me distancat dhe transportin, për pjesëmarrjen e rregullt në aktivitete psiko-sociale jashtë orarit mësimor. Mungesa e një roli të dedikuar për mbrojtjen e fëmijës dobëson identifikimin e hershëm, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve.

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në Bashkinë Fushë-Arrëz, sipas Censit 2023, jetojnë 619 fëmijë nga një popullsi prej 4,878 banorësh. Rrjeti arsimor përfshin gjashtë kopshte, katër shkolla 9-vjeçare dhe një shkollë të mesme. Në kopsht frekuentojnë 67 fëmijë (31 vajza, 36 djem), ndërsa në arsimin bazë dhe të mesëm janë të regjistruar 437 nxënës (209 vajza, 228 djem). Arsimi gjithëpërfshirës përfshin shtatë fëmijë me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën (dy në arsimin bazë dhe pesë në të mesëm); gjashtë prej tyre banojnë në Fushë-Arrëz.

449 fëmijë të moshës 0–18 vjeç jetojnë në familje që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike (350 janë 0–15 vjeç dhe 99 janë 16–18 vjeç); prej tyre, 251 ndjekin shkollën (131 vajza). Shpërndarja territoriale tregon përqendrim më të lartë në njësinë administrative Fierzë (127 fëmijë), pasuar nga Iballë (99), Blerim (76), Qafë Mali (76) dhe Fushë-Arrëz (71). Mbizotërimi i grupmoshës 0–15 vjeç sinjalizon nevoja për ndërhyrje të hershme, përfshirje parashkollore dhe mbështetje në arsimin e detyrueshëm; pabarazitë ndërmjet njësive orientojnë prioritarizimin drejt Fierzës dhe Iballës, shiko figurën 11.

Figura 11. Fëmijët që jetojnë në familje me NE, sipas Njësive Administrative



Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024

Të dhënat ofrojnë një pasqyrë të kufizuar për fëmijët jashtë skemës së NE dhe nuk mundësojnë vlerësim krahasues në të gjithë territorin. Për arsimin mungojnë tregues mbi vijueshmërinë dhe braktisjen. Për fëmijët me aftësi të kufizuara mungon informacion mbi ata jashtë arsimit, llojin e aftësisë, vlerësimet funksionale dhe mbështetjet (asistentë, transport, terapi). Po ashtu, nuk ka të dhëna administrative mbi raste të mbrojtjes së fëmijës (dhunë, punë e fëmijëve, situatë rruge), shëndetin apo aksesin në shërbime psiko-sociale. Këto boshllëqe kufizojnë vlerësimin e përmasës së problemit, krahasimin midis njësive, planifikimin e synuar të ndërhyrjeve dhe buxhetit.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Shkollat dhe kopshtet funksionojnë si nyje të përfshirjes ditore, por nuk ka vlerësim të aksesit ditor (transport, akomodime, mbështetje plotësuese). Distanca midis vendbanimeve dhe shkollave/kopshteve, e vështirësojnë pjesëmarrjen e rregullt në aktivitete dhe aksesin në mbështetje psiko-sociale jashtë orarit mësimor. Shërbimet shoqërore të strukturuar për fëmijët mungojnë në nivel bashkie dhe NJA. Roli i punonjësit/NJMF nuk është i mirëpërcaktuar. Ekziston bashkëpunimi ndërinstitucional midis bashkië, institucionit arsimor dhe policisë, por zbatimi praktik nuk është në nivelin e duhur.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

Bazuar në analizën e mësipërme, nevojitet:

- ✓ Funksionimi i një mekanizmi të strukturuar për evidentim, vlerësim dhe referim të fëmijëve në nevojë dhe qartësim i rolit të NJMF.
- ✓ Databazë e integruar për fëmijët në nevojë/trezik
- ✓ Ngritja e shërbimeve shoqërore bazë për fëmijët
- ✓ Protokolle bashkëpunimi ndërinstitucional për shkëmbim periodik të të dhënave mbi fëmijët.

Në Bashkinë Fushë-Arrëz, kopshtet dhe shkollat janë hapësirat kryesore të përditshme për fëmijët dhe një bazë e mirë për shtrirjen e mbështetjes, por distanca dhe transporti kufizojnë aksesin në shërbime pas orarit mësimor. Më të ekspozuar janë fëmijët në familje përfituese të Ndihmës Ekonomike dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kërkojnë ndërhyrje të hershme dhe mbështetje të qëndrueshme në arsim. Në nivel bashkie mungojnë shërbime të strukturuar specifike për fëmijët dhe roli i NJMF nuk është i qartësuar. Nevojitet një mekanizëm i unifikuar për evidentim, vlerësim dhe referim, një databazë e integruar dhe protokolle periodike shkëmbimi të dhënash midis ofruesve të shërbimeve publikë dhe jo publikë, për të rritur mbulimin dhe cilësinë e mbrojtjes së fëmijës në të gjithë territorin.

5-Të moshuar në nevojë

Kjo rubrikë trajton njerëzit e moshës së tretë që kanë nevoja të shtuara për informim, orientim dhe shërbime pranë banesës, me synim ruajtjen e autonomisë dhe dinjitetit. Në një territor malor e të shpërndarë si Fushë-Arrëz, distancat, të ardhurat e kufizuara dhe varësitë funksionale rrisin rrezikun e izolimit social. Analiza vijon me përshkrimin e sfidave, gjendjen e të dhënave dhe boshllëqeve, si dhe shërbimet ekzistuese dhe mbulimin, si bazë për ndërhyrje të matshme në nivel njësisht administrative.

Përshkrimi i grupit dhe sfidat kryesore

Të moshuar në nevojë janë banorët 65+ që kanë nevoja specifike për informacion/orientim, mbështetje shoqërore dhe akses në shërbime afër banesës. Sfidat kryesore lidhen me izolimin social, të ardhurat e kufizuara, gjendjen

shëndetësore/varësinë funksionale, transportin dhe mungesën e shërbimeve të strukturuar në nivel vendor.

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në Bashkinë Fushë-Arrëz jetojnë 4,787 banorë; 804 janë 65+, pra rreth 16.8% e popullsisë. Nga këta, 58 të moshuar jetojnë në familje që përfitojnë Ndihmë Ekonomike (NE). Përtej këtij niveli bazë, mungojnë të dhëna të detajuara mbi "të moshuarit në nevojë" (p.sh. që jetojnë vetëm, me kufizime funksionale, me Aftësi të Kufizuara, në rrezik social), si dhe nuk dokumentohen përdorimi i shërbimeve dhe rezultatet (dalje nga NE, përfitim shërbimesh, etj.). Këto boshllëqe e bëjnë të paqartë përmasën reale të problemit: nuk dihet numri/profili i të moshuarve në nevojë, shpërndarja sipas njësive dhe nevojat kryesore. Ndërtimi i kwsaj "harte", përbën kusht për planifikim të qëndrueshëm të shërbimeve shoqërore, shtrirje të drejtë territoriale dhe buxhetim të arsyetuar.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht nuk ofrohen shërbime shoqërore të dedikuara për moshën e tretë (p.sh. qendër ditore, kujdes në familje, menaxhim rasti). Kontakti i të moshuarve me shërbimet realizohet përmes administratorëve shoqërorë në njësitë administrative (dëgjim, informim dhe orientim). Rregullorja e Bashkisë nuk parashikon një specialist për moshën e tretë dhe NJVRN, çka e bën të paqartë kanalin e referimit dhe pamundëson matjen e mbulimit real.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

Sa më sipër nevojitet:

- ✓ Parashikimi dhe formalizimi në rregullore/organikë i pozicionit specialist për moshën e tretë (funksion koordinues/menaxhim rasti).
- ✓ Ngritja e NJVRN.
- ✓ Ngritjen e regjistrit për identifikimin e të moshuarve në nevojë, nevojat e tyre dhe shërbimet e marra; raportim i unifikuar ndërmjet njësive.
- ✓ Ngritja e shërbimeve bazë të aksesueshme (p.sh. ditore, vizita në shtëpi/kujdes në familje, këshillim bazik, menaxhim rasti), me shtrirje graduale në territor.
- ✓ Rritje kapacitetesh për administratorët shoqërorë (identifikim i hershëm, vlerësim nevojash, referim/ndjekje, dokumentim).
- ✓ Ndërgjegjësimi i komunitetit për mbështetje dhe nevojat për shërbime për të moshuarit në nevojë.

Diagnoza prezanton se të moshuarit përbëjnë 16.8% të popullsisë; përveç numrit total dhe faktit që 58 janë në familje përfituese të NE, mungon evidenca e detajuar për "të

moshuarit në nevojë", nuk ka shërbime të dedikuara, ndërsa pozicioni përgjegjës dhe NJVRN nuk janë të formalizuara. Kjo kërkon rregullim institucional dhe vendosje të mekanizmit të vlerësim-referimit, që identifikimi, planifikimi dhe mbështetja për moshën e tretë të bazohen në të dhëna dhe të kenë mbulim të qartë në të gjithë territorin.

5. Dhuna në familje/viktimat e dhunës

Dhuna në familje përfshin dëmtim fizik, psikologjik, seksual apo ekonomik, si dhe kontroll, kërcënim apo përndjekje ndaj një anëtarit të familjes/partnerit etj. Viktimë dhune është çdo person që përjeton këto forma brenda marrëdhënieve familjare, bashkëjetesës, partneritetit ose kujdestarisë. Ky përkufizim është në përputhje me Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare".

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Në maj 2024 Bashkia nuk raporton raste dhune; në vitet 2022 dhe 2023 raporto vetëm një rast. Këto shifra nuk nënkuptojnë mungesë dhune. Zero-raportimi lidhet me komunitetin e vogël dhe privatësinë e lartë, frikën nga ekspozimi dhe gjykimi, pasigurinë ekonomike, mungesën e informacionit për rrugët e sigurta të raportimit dhe mungesën e një pike të qartë qartë kontakti për raportim. Në këtë fazë, bashkëpunimi ndër-institucional nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Roli i koordinatorit për dhunën dhe barazinë gjinore nuk është i konsoliduar në rregulloren e brendshme dhe kryhet de facto nga një punonjës i sektorit social; mungon figura formale që të menaxhojë rastet dhe të organizojë grupet/tryezat teknike. Nuk ofrohen shërbime shoqërore të dedikuara për këtë kategori (p.sh. këshillim i strukturuar, menaxhim rasti, strehim emergjent, mbështetje ligjore). Shërbimi i vetëm aktual janë shërbimet të mundësuar nga administratorët shoqërorë në njësitë administrative (dëgjim, informim bazik, orientim dhe asistencë dokumentare); shpesh administratori mban edhe funksione si specialist i barazisë gjinore apo specialistin e NJVRN, pa u formalizuar. NJVRN (Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave) nuk është ngritur. Formalizimi i koordinatorit dhe ngritja e NJVRN janë detyrime ligjore respektivisht nga VKM nr. 334/2021 & Ligji nr. 9669/2006 dhe Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

Nevoja për ndërhyrje prioritare lidhen me:

- ✓ Institucionalizimin në rregullore i rolit të koordinatorit për dhunën dhe barazinë gjinore.
- ✓ Rritja e kapaciteteve të stafit aktual (administratorë shoqërorë/sektori social) për identifikim të hershëm, vlerësim rreziku, menaxhim rasti, konfidencialitet dhe dokumentim.
- ✓ Ngritja dhe funksionimi i NJVRN.

- ✓ Integrimi i programeve të parandalimit dhe ndërgjegjësimi në shërbimet ekzistuese ose që do të ngrihen (informim i qartë, kanale diskrete raportimi, mesazhe mbi të drejtat dhe mbështetje).

Diagnoza prezanton se aktualisht bashkia nuk disponon të dhëna operative; nuk ka raportime të rasteve të dhunës për periudhën raportuese. Në rregulloren e bashkisë nuk figuron pozicioni koordinator i dhunës dhe barazisë gjinore si dhe NJVRN nuk është ngritur. Kontakti me qytetarët realizohet përmes administratorëve shoqërorë (dëgjim, informim dhe orientim). Kjo panoramë sinjalizon nevojën për formalizim të roleve dhe ngritjen e mekanizmit të vlerësimit/referimit, duke hedhur bazat për monitorim të rregullt dhe qasje më të qartë në mbështetje.

7. Përdorues droge

Përdoruesit e drogave përballen me rreziqe të larta shëndetësore e sociale, stigmatizim dhe konflikte familjare, shpesh të shoqëruara me braktisje shkolle, humbje pune dhe izolim nga komuniteti. Frika nga paragjykimimi i mban larg shërbimeve, ndaj kontaktet me institucionet ndodhin vonë dhe vetëm në momente krize.

Aktualisht Bashkia nuk ka të dhëna të strukturuar dhe nuk ofron shërbime shoqërore të dedikuara as për personat, as për familjet e tyre. Ngritja e NJVRN do të siguronte identifikim konfidencial, vlerësim të nevojave (psiko-sociale, arsim/punësim, strehim) dhe referim të koordinuar drejt shëndetësisë dhe mbështetjes sociale, si dhe ndjekje të rastit me plane të thjeshta veprimi.

8. Përdorues alkooli

Përdorimi i dëmshëm i alkoolit shoqërohet me konflikte familjare, dhunë në shtëpi, rënie të performancës në punë dhe përkeqësim të shëndetit mendor/fizik; shpesh konsiderohet "çështje private", ndaj kërkimi i ndihmës vonohet. Familjet bartin barrë të madhe kujdesi pa udhëzime profesionale.

Bashkia nuk disponon të dhëna për përmasat e problemit dhe nuk ka shërbime shoqërore të posaçme për këtë grup dhe familjet e tyre. NJVRN mund të shërbejë si porta e parë: evidentim konfidencial, vlerësim i rrezikut dhe nevojave, më pas referim (këshillim bazik, ndërmjetësim me shërbimet shëndetësore, orientim drejt punësimit) dhe ndjekje deri në stabilizim.

9. Persona LGBTQ+

Personat LGBTQ+ përballen me stigmatizim, diskriminim dhe rrezik të shtuar për dhunë psikologjike/fizike, bullizëm në shkollë dhe pengesa në aksesin ndaj shërbimeve; këto ndikojnë në mirëqenie dhe në mundësitë për arsim e punë. Familjet shpesh ndihen të paqarta për mënyrat e mbështetjes, çka rrit rrezikun e izolimit.

Bashkia nuk ka të dhëna të grumbulluara dhe nuk ofron shërbime shoqërore të dedikuara për këtë grup. NJVRN do të krijonte një rrugë të sigurt raportimi dhe mbështetjeje: identifikim dhe vlerësim konfidencial i nevojave, referim për këshillim psiko-social dhe shërbime arsimore/shëndetësore, ndërmjetësim institucional në rast diskriminimi apo dhune, si dhe orientim për familjet—duke rritur besimin dhe aksesin pa paragjykim.

13 Diagnoza për shërbimet shoqërore në Bashkinë Fushë-Arrëz

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” përcakton shërbimet shoqërore si ndërhyrje jomonetare parandaluese, mbështetëse dhe integruuese, të ofruara në komunitet ose rezidencë. Bashkia ka detyrimin ligjor t’i planifikojë, organizojë, financojë dhe monitorojë këto shërbime, duke siguruar minimalisht funksionimin e “shportës bazë”: informim/referim, vlerësim të nevojave dhe menaxhim rasti, këshillim psiko-social bazë, shërbime ditore komunitare dhe kujdes bazik në familje, si dhe lidhje me shërbimet e specializuara. Kjo diagnozë vlerëson përputhshmërinë e gjendjes aktuale me këto kërkesa dhe evidenton boshllëqet për funksionalizimin e shportës bazë.

Përshkrimi i gjendjes aktuale dhe sfidat kryesore

Shërbimet shoqërore në Bashkinë Fushë-Arrëz janë në fazë konsolidimi dhe mbështeten kryesisht te strukturat vendore ekzistuese. Administratorët shoqërorë ofrojnë shërbime parashoqërore të orientimit dhe asistencës për familjet dhe individët në nevojë. Ndërkohë, rolet e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) dhe Koordinatorit për Dhunën nuk janë ende të qartësuara/formalizuara; funksionet përkatëse mbulohen nga stafi i sektorit social, çka kufizon kapacitetin për shërbime të specializuara në komunitet.

Diagnozat për kategoritë në nevojë evidentojnë se mungesa e një rrjeti të zhvilluar shërbimesh dhe e mekanizmave të integruar të menaxhimit të rasteve mbetet një sfidë kryesore. Këto sfida thellohen gjatë periudhës së dimrit, kur rriten nevojat dhe vështirësohet qasja në shërbime dhe koordinimi ndërinstitutional.

Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Aktualisht, Bashkia Fushë-Arrëz nuk disponon qendra komunitare, qendra ditore apo programe të kujdesit në familje dhe rezidencial. Mbështetja në terren sigurohet kryesisht nga administratorët shoqërorë, të cilët ofrojnë asistencë bazike parashoqërore dhe orientojnë rastet drejt institucioneve përkatëse ose OJF-ve në qarkun Shkodër.

Mungon një databazë e integruar e rasteve dhe Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN), çka kufizon aftësinë e bashkisë për monitorim, ndjekje sistematike dhe planifikim të bazuar në evidencë. Shërbimet emergjente mbulohen rast pas rasti nga

komunitetet fetare ose OJF-të, ndërsa bashkia nuk ka një linjë buxhetore të dedikuar për situata të tilla.

Në vijim, Figura pasqyron ndërhyrjet që po zbatohen përmes projekteve mbështetëse/ekonomike të integruara (formim, punësim, ndërgjegjësim), ndërkohë që shërbimet shoqërore të strukturuar si qendra ditore, kujdes në familje, shërbime komunitare të integruara mungojnë.

Figura 12 : projektet që ofrojnë ndërhyrje/mbështetje për individët në nevojë në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

Titulli i projektit	Fokusi	Kategoritë përfituese	Donatori / Program i	OJF zbatuese	Partnerit et me Bashkinë
Qendër Komunitare Shumëdisiplinore për rintegrim social-ekonomik – “Së bashku për zhvillimin shoqëror dhe social të Bashkisë Fushë-Arrëz” (2024-2027)	Këshillim psiko-social, orientim drejt punësimit, shërbime komunitare për rintegrim social-ekonomik	Familje në nevojë; individë në rrezik social	Fondi Social – financiar nga MSHMS dhe Bashkia Fushë-Arrëz	Shoqata “Qendra Sociale në Ndihamë të Nevojë” (QSNNN)	Po
DUARARTA – Ndërmarrja Sociale (2024-2027)	Formim profesional dhe mundësi punësimi në industrinë e bimëve mjekësore	Gra të marginalizuara dhe në nevojë	MSHMS	Shoqata QSNNN – Ndërmarrja Sociale “DUARARTA”	Nuk specifikohet
RurALB – Zhvillimi i turizmit Fushë-Arrëz-Bicaj-Mali i Krrabit (2024)	Promovim shtegu turistik, fuqizim komunitar dhe aktivizim ekonomik lokal	Komuniteti lokal; aktorë të turizmit	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Shoqata QSNNN	Nuk specifikohet
ËOMEN	Rritje	Gra dhe	SPACE	Shoqata	Nuk

HEALTH (2024)	njohuri shëndetësor e dhe advokim për politika lehtësuese	vajza në Fushë-Arrëz dhe Pukë	sub- grants (TFL) në partnerite t me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare, Destiny Center	QSNNN	specifikohet
ECO-PATH – Korridori Ekologjik Fushë- Arrëz-Iballë (2024–2025)	Ndërgjegjësi m dhe forcim komuniteti për zhvillim të qëndrueshmë m	Komunitetet në korridorin Fushë- Arrëz-Iballë	CNVP Foundati on	Shoqata QSNNN	Nuk specifikohet

Kapaciteti financiar i Bashkisë Fushë-Arrëz është i kufizuar, me të ardhura vetjake të ulëta dhe hapësirë të ngushtë për bashkëfinancim. Si rrjedhojë, planifikimi, zgjerimi dhe qëndrueshmëria e shërbimeve—veçanërisht komponentëve të “shportës bazë”—varen kryesisht nga transfertat e përgjithshme dhe të kushtëzuara të qeverisjes vendore dhe nga grantet/projektet. Kjo varësi kufizon fleksibilitetin për shtrirje territoriale, standardizim cilësie dhe mbulim të emergjencave, duke e bërë të domosdoshme prioritarizimin, fazimin dhe kontraktimin selektiv të ofruesve.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

Në këtë kuadër, përcaktimi i nevojave orientohet drejt funksionalizimit të “shportës bazë” dhe mekanizmave mbështetës, përmes zgjidhjeve të shkallëzuara me kosto efektive, në përputhje me kapacitetin buxhetor vendor. Konkretisht:

- ✓ Ngritja dhe funksionalizimi i Njesisë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN) për koordinimin e rasteve komplekse.
- ✓ Zhvillimi i shërbimeve të strukturuar sociale (qendra ditore, qendra komunitare dhe programe të kujdesit në familje) për grupet më vulnerabël.
- ✓ Sigurimi i një buxheti të dedikuar për emergjencat sociale dhe mbështetjen e rasteve të evidentuara nga administratorët shoqërorë, PMF dhe Koordinatori i Dhunës.
- ✓ Fuqizimi i rolit të PMF, Koordinatorit të Dhunës dhe administratorëve shoqërorë për të përmirësuar zinxhirin e mbrojtjes sociale.
- ✓ Krijimi i databazave të integruara për planifikimin e bazuar në evidencë dhe ndërtimin e politikave sociale të qëndrueshme.

Si përmbyllje, diagnoza tregon se, pavarësisht boshllëqeve në "shportën bazë" dhe mekanizmave mbështetës (NJVRN, databaza e rasteve, menaxhim rasti), Bashkia Fushë-Arrëz ka bazë të qartë për konsolidim. Përmes shërbimeve integruese në zbatim—këshillim bazë, orientim drejt punësimit, formim profesional dhe ndërgjegjësim përmes projekteve komunitare—po fuqizohen gradualisht kategoritë në nevojë. Formalizimi i roleve të PMF dhe Koordinatorit të Dhunës, ngritja e NJVRN dhe një buxhet i dedikuar për emergjencat sociale do të mundësojnë funksionalizimin e plotë të "shportës bazë" dhe rritjen e aksesit, cilësisë dhe ndikimit social.

IV. Burimet njerëzore

Rubrika paraqet një analizë të strukturuar të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve të Bashkisë Fushë-Arrëz për mbrojtjen sociale. Ajo përfshin përshkrimin e strukturës aktuale, vlerësimin e kapaciteteve për menaxhimin e rasteve dhe identifikimin e nevojave për riorganizim, shtim stafi dhe trajnime, mbi bazën e kuadrit ligjor kombëtar, praktikave aktuale dhe specifike territoriale dhe demografike. Staf i shërbimeve sociale ka rol kyç në garantimin e shërbimeve bazë për grupet vulnerabël; ndaj forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe organizative mbetet domosdoshmëri për një mbrojtje sociale efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Struktura aktuale

Struktura e burimeve njerëzore për çështjet sociale është e kufizuar si në numër, ashtu edhe në funksione. Sektori për çështjet sociale bën pjesë në Drejtorinë e Migracionit, Diasporës dhe Çështjeve Sociale dhe drejtohet nga një përgjegjës sektori; disa pozicione janë të kufizuara, ndër to një specialist për PAK dhe një Koordinator për Barazim Gjinor. Në disa njësi mungojnë administratorët shoqërorë (Fierzë dhe Fushë-Arrëz), ndërsa në të tjera ata janë të emërtuar si "specialistë për ndihmën ekonomike" dhe ushtrojnë funksione të gjera sociale. Roli i specialistit të çështjeve sociale është i paqartë dhe mbulon funksione të përziera. Mungon NJVRN (Njësia e Vlerësimit dhe Referimit në nivel vendor) një strukturë kyçe e kërkuar nga Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror".

Kapacitetet për vlerësim dhe ndërhyrje

Kapacitetet për vlerësim dhe ndërhyrje janë të kufizuara si në qendër, ashtu edhe në njësitë administrative. Përgjegjësi i sektorit mbulon funksione koordinuese /administrative, por nuk mbështetet nga staf i specializuar për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe të dhunës në familje. Administratorët shoqërorë janë të ngarkuar dhe jo të trajnuar për ndërhyrje të thelluara ose për ndërtimin e planeve të personalizuar të ndërhyrjes. Procesi aktual i vlerësimit është i fragmentuar dhe mbështetet më shumë në

përvojë individuale se në procedura të standardizuara, duke kufizuar funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale dhe hartimin e politikave të bazuara në evidence (të dhëna).

Nevojat për shtesë staf, riorganizim dhe trajnime

Për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të garantuar funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale, Bashkia Fushë-Arrëz ka nevojë për një qasje të balancuar midis riorganizimit të brendshëm dhe forcimit të kapaciteteve ekzistuese. Në kushtet e një popullsie më të vogël se 10,000 banorë dhe buxhetit të kufizuar, është e pamundur të shtohen 11 punonjës për të mbuluar funksionet e PMF, Koordinatorit për Dhunën dhe NJVRN në të gjitha njësitë; për rrjedhojë, propozohet emërimi i një punonjësi me funksione të dyfishta (PMF dhe Koordinator për Dhunën) dhe ngritja e një NJVRN fleksibël ku administratorët shoqërorë angazhohen sipas rastit. Këto masa mundësojnë ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv edhe në kushtet e burimeve të kufizuara.

Figura 13. Figura përmbledhëse e mospërputhjeve ndërmjet strukturës aktuale dhe kërkesave ligjore

Elementi/Aspekti	Sipas Rregullores aktuale	Në praktikën aktuale	Kërkesat ligjore
PMF	Nuk figuron	Disa funksione mbulohen nga përgjegjësi sektori	Ligji nr. 18/2017 kërkon emërim të dedikuar
Koordinatori për Dhunën	Nuk figuron si rol më vete	Mbulohet informal nga sektori	VKM nr. 334/2021 kërkon emërim të dedikuar
Administratorët Shoqërorë	Të emërtuar si "specialistë NE"	Kryejnë funksione të gjera sociale	Përshkrim i qartë në rregullore, sipas Ligjit nr. 121/2016
NJVRN	Nuk ekziston	Nuk është funksionale	Ligji nr. 121/2016 kërkon ngritjen e saj të përbërë nga PMF dhe punonjës socialë
Varësia dyfishe e administratorëve shoqërorë	Nuk përcaktohet qartë	Është dyfishe, por jo e formalizuar	Duhet të formalizohet në rregullore
Specialisti i Çështjeve Sociale	Pozicion i përgjithshëm	Mbulon funksione të përziera	Roli i qartë për mbështetje të kategorive (PAK, fëmijë, dhunë)

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023–2030, parashikohen trajnime të detyrueshme për: procedurat standarde të mbrojtjes së fëmijëve; menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; hartimin e planeve të individualizuara të ndërhyrjes; përdorimin e formularëve të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave. Grupi i synuar përfshin administratorët shoqërorë (specialistë për ndihmën ekonomike), përgjegjësin e sektorit, punonjësit që do të emërohen si PMF, Koordinator për Dhunën dhe anëtarë të NJVRN; ofruesit mund të jenë ASPA, Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, MSHMS, si dhe partnerë/donatorë (UNICEF, UNDP, Save the Children, Terre des Hommes).

V. Analiza SWOT

Analiza SWOT paraqet një vlerësim të pozicionit aktual të Bashkisë Fushë-Arrëz në raport me kapacitetet dhe sfidat për zbatimin e Planit Social Vendor 2025–2028. Kjo analizë ndihmon në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në suksesin e planit, duke shërbyer si bazë për orientimin strategjik dhe përzgjedhjen e ndërhyrjeve prioritare.

Pikat e forta

- Potencial i lartë natyror dhe turistik: prani e pasurive pyjore, peizazheve natyrore dhe burimeve ujore që krijojnë mundësi për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe eko-turizmit.
- Prani e aktorëve lokalë të angazhuar në çështjet sociale dhe mbështetje nga donatorë ndër vite.
- Eksperienca pozitive në zbatimin e projekteve sociale në partneritet me MSHMS dhe organizata të tjera.
- Vullnet i lartë politik dhe angazhim i Bashkisë për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe përfshirjen e grupeve në nevojë.
- Funksionimi i sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale si strukturë e dedikuar për mbrojtje sociale.

Pikat e dobëta

- Mungesa e shërbimeve sociale të strukturuar dhe të specializuara për grupet vulnerabël.
- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe profesionale në sektorin social.
- Mungesa e të dhënave të detajuara për grupet në nevojë në territor.
- Infrastrukturë e dobët rrugore dhe largësi gjeografike që kufizojnë aksesin në shërbime.

- Mungesë e mekanizmave funksionalë për identifikimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve.

Mundësitë

- Potencial për zhvillimin e turizmit malor, agroturizmit dhe industrisë së përpunimit të produkteve natyrore (p.sh. bimë mjekësore, pyje).
- Akses në programe dhe fonde të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe donatorëve ndërkombëtarë.
- Mundësi për ngritjen e sipërmarrjeve sociale dhe punësim në sektorë të gjelbër.
- Përdorimi i energjisë së rinovueshme si një mundësi për zhvillim dhe përfshirje ekonomike.
- Bashkëpunimi me OJF dhe institucione arsimore për zhvillim komunitar dhe aftësim profesional.

Kërcënimet

- Tkurja e popullsisë dhe migrimit të të rinjve drejt qyteteve më të mëdha ose jashtë vendit.
- Pasiguri në vazhdimësinë e mbështetjes financiare nga projektet dhe donatorët.
- Mungesë interesi nga ofruesit e shërbimeve për të operuar në zona të largëta dhe me infrastrukturë të dobët.
- Rritja e nevojave sociale për shkak të varfërisë, papunësisë dhe izolimit gjeografik.

VI.Parimet, vizioni, misioni dhe qëllimi i planit

Parimet udhëheqëse të planit:

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit: garantimi i aksesit të barabartë në shërbime shoqërore për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie, moshe, etnie, statusi social apo vendbanimi.

Parimi i mbrojtjes së grupeve vulnerabël: fokusimi në identifikimin në kohë, ofrimin e mbështetjes së përshtatshme dhe promovimin e përfshirjes sociale të personave dhe familjeve në nevojë apo në rrezik përjashtimi shoqëror.

Parimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes: përfshirja aktive e komuniteteve, OJF-ve dhe aktorëve lokalë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit.

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe integruar: ndërlidhja e masave të mbrojtjes sociale me zhvillimin lokal dhe përdorimi efikas i burimeve ekzistuese.

Parimi i përgjegjshmërisë, transparencës dhe vlerësueshmërisë: zbatimi i masave sociale bazohet në objektiva të qarta, indikatorë të vlerësueshëm dhe mekanizma të mirëpërcaktuar për monitorim, raportim dhe llogaridhënie në nivel vendor.

Vizioni

Të ndërtojmë një bashki të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për mirëqenie dhe pjesëmarrje, ndërsa mbrojtja sociale ecën krah zhvillimit ekonomik, turizmit të gjelbër dhe energjisë së pastër.

Misioni i planit

Të zhvillojmë një sistem shërbimesh sociale efektiv, të koordinuar dhe të qëndrueshëm që garanton mbështetje për kategoritë në nevojë dhe i orienton ato drejt përfshirjes sociale dhe ekonomike, nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional, fuqizimit të kapaciteteve lokale dhe promovimit të iniciativave për vetëpunësim dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Qëllimi i përgjithshëm i planit

Të sigurojmë akses të barabartë dhe cilësor në shërbimet sociale për të gjitha kategoritë vulnerabël, duke mbështetur njëkohësisht aftësimin, përfshirjen në zhvillimin lokal dhe krijimin e partneriteteve që mundësojnë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në Bashkinë Fushë-Arrëz.

VII. Prioritetet dhe objektivat specifike

Plani Social Vendor i Bashkisë Fushë-Arrëz për periudhën 2025–2028 mbështetet në tre shtylla prioritare që synojnë jo vetëm mbrojtjen e grupeve në nevojë, por edhe orientimin dhe fuqizimin e tyre për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik, kulturor, natyror dhe potencialet mjedisore të territorit. Objektivat e përcaktuara janë në përputhje me vizionin e bashkisë për një plan social të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të integruar me zhvillimin lokal.

Prioriteti 1: Zhvillimi i shërbimeve sociale bazuar në nevojat e grupeve vulnerabël

Ky prioritet synon përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve sociale për të gjitha kategoritë në nevojë, me fokus në ofrimin e ndërhyrjeve të strukturuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Objektivi 1.1: Të garantohen shërbime sociale bazike dhe të specializuara për grupet vulnerabël në të gjithë territorin.

Masa 1.1: Ngritja e një qendre multifunkionale për familjet, fëmijët dhe individët në nevojë

Aktivitete:

- ✓ A1.1.1: Realizimi i një vlerësimi të nevojave të komunitetit për shërbime sociale.
- ✓ A1.1.2: Sigurimi i hapësirës dhe pajisjeve për funksionimin e qendrës.
- ✓ A1.1.3: Emërimi i stafit të nevojshëm për funksionimin e qendrës.
- ✓ A1.1.4: Hartimi i një programi vjetor të aktiviteteve dhe shërbimeve që do të ofrohen.
- ✓ A1.1.5 Ofrimi i shërbimeve shoqërore

Treguesit:

- 1 dokument i vlerësimit të nevojave hartuar dhe miratuar
- 1 hapësirë funksionale me të paktën 3 dhoma shërbimi
- 3 anëtarë staf të rekrutuar për qendrën
- 1 program vjetor i zbatuar me të paktën 10 aktivitete komunitare
- Qendra funksionale

Masa 1.2: Zhvillimi i shërbimit lëvizës për të moshuarit dhe PAK

Aktivitete:

- ✓ A1.2.1: Hartimi i modelit të funksionimit të shërbimit lëvizës.
- ✓ A1.2.2: Përzgjedhja e përfituesve në bashkëpunim me njësitë administrative.
- ✓ A1.2.3: Trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve në terren.
- ✓ A1.2.4: Sigurimi i mjeteve të transportit dhe logjistikës.

Treguesit:

- 1 model funksional i dokumentuar
- Të paktën 30 përfitues të identifikuar dhe të asistuar
- 5 staf të trajnuar për shërbime në terren
- 1 automjet dhe 10 njësi logjistike të siguruara

Masa 1.3: Ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në rrezik dhe viktimat e dhunës

Aktivitete:

- ✓ A1.3.1: Zhvillimi i një pakete shërbimesh psiko-sociale për rastet në nevojë.
- ✓ A1.3.2: Organizimi i ndërhyrjeve në terren për menaxhimin e rasteve urgjente.
- ✓ A1.3.3: Bashkëpunimi me njësitë për referimin e rasteve.

Treguesit:

- Të paktën 20 raste të trajtuara me shërbime psiko-sociale
- 10 ndërhyrje në terren të kryera
- 3 marrëveshje me qendra të specializuara

Prioriteti 2: Përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i grupeve në nevojë

Ky prioritet synon të rrisë përfshirjen aktive të personave në nevojë në jetën ekonomike dhe komunitare, duke i orientuar drejt aftësimit, edukimit dhe shfrytëzimit të potencialit lokal në bujqësi, turizëm, artizanat dhe energji të rinovueshme.

Objektivi specifik 1: Promovimi i përfshirjes sociale dhe edukimit të grupeve në nevojë

Masa 1.1: Organizimi i aktiviteteve komunitare dhe cikleve edukative

Aktivitete:

- ✓ A 1.1.1 Organizimi i të paktën 6 aktiviteteve komunitare në vit në njësitë administrative.
- ✓ A 1.1.2 Zhvillimi i 4 cikleve edukative për aftësitë e jetës dhe ndërgjegjësimin social.

Tregues:

- Numri i aktiviteteve komunitare të realizuara: 6 në vit
- Numri i cikleve edukative të realizuara: 4 në vit
- Numri i përfituesve total nga aktivitetet: 120 individë në vit

Masa 1.2: Zbatimi i projekteve sociale për gratë dhe fëmijët në nevojë

Aktivitete:

- ✓ A 1.2.1 Zbatimi i 2 projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë vulnerabël.
- ✓ A 1.2.2 Zbatimi i projektit për mbështetje psiko-sociale për fëmijët në rrezik.

Tregues:

- Numri i projekteve të zbatuara: 2 në vit
- Numri i grave/vajzave të përfshira: 80 në vit
- Numri i fëmijëve të mbështetur: 20 në vit

Objektivi specifik 2: Aftësimi profesional dhe mbështetja për vetëpunësim

Masa 2.1: Organizimi i kurseve të formimit profesional

Aktivitete:

- ✓ A 2.1.1 Organizimi i 3 kurseve profesionale në bashkëpunim me DAR/ZVA ose qendra trajnimi.

Tregues:

- Numri i kurseve të organizuara: 3 në vit
- Numri i përfituesve të trajnuar: 60 individë në vit

Masa 2.2: Mbështetje me minigrante ose pajisje për vetëpunësim

Aktivitete:

- ✓ A 2.2.1 Ngritja e një fondi të vogël mbështetës për vetëpunësim.
- ✓ A 2.2.2 Mbështetje me pajisje për 10 individë në vit.
- ✓ A 2.2.3 Zbatimi i projektit DUARARTA për ngritjen e kapaciteteve dhe vetëpunësimin e grave.

Tregues:

- Numri i individëve të mbështetur me grante ose pajisje: 10 në vit
- Numri i bizneseve të vogla të krijuara: 5 në vit
- Të paktën 20 gra të përfshira në ndërmarrjen sociale çdo vit.

Objektivi specifik 3: Nxitja e përfshirjes në zhvillimin e qëndrueshëm

Masa 3.1: Bashkëpunim me fermerë dhe subjekte turistike

Aktivitete:

- ✓ A 3.1.1 Nënshkrimi i 5 marrëveshjeve bashkëpunimi me fermerë/subjekte.
- ✓ A 3.1.2 Përfshirja e grupeve në nevojë në të paktën 3 nisma ekonomike.

Tregues:

- Numri i marrëveshjeve të nënshkruara: 5
- Numri i përfituesve të përfshirë: 30 individë

Masa 3.2: Trajnime për punë të gjelbra dhe ekonomi qarkuluese

Aktivitete:

- ✓ A 3.2.1 Organizimi i 2 cikleve trajnimi për punësim të gjelbër dhe riciklim.

Tregues:

- Numri i trajnimeve të realizuara: 2 në vit
- Numri i pjesëmarrësve në trajnim: 40 në vit

Prioriteti 3: Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe e partneriteteve për shërbime sociale efektive

Objektivi specifik 1: Rritja e kapaciteteve të stafit dhe strukturave vendore

Masa 1.1: Trajnimi i stafit për menaxhimin e rasteve dhe mbrojtjen sociale

Aktivitete:

- ✓ A 1.1.1: Zhvillimi i një moduli trajnimi për menaxhimin e rasteve sociale
- ✓ A 1.1.2: Organizimi i 4 sesioneve trajnimi në vit për administratorët dhe stafin social

Tregues:

- 1 modul trajnimi i zhvilluar
- 4 trajnime të organizuara në vit
- 40 pjesëmarrës të trajnuar çdo vit

Objektivi specifik 2: Themelimi i mekanizmave funksionalë për mbrojtje sociale

Masa 2.1: Funksionalizimi i NjVRN dhe ndjekja elektronike e rasteve

Aktivitete:

- ✓ A.2.1.1: Hartimi i strukturës dhe përshkrimeve të punës për anëtarët e NjVRN
- ✓ A.2.1.2: Trajnimi i stafit
- ✓ A 2.1.3 Ndertimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të ndjekjes së rasteve

Tregues:

- 1 strukturë e miratuar për NjVRN
- 10 anëtarë të trajnuar
- Sistemi elektronik funksional për 100% të rasteve të reja

Objektivi specifik 3: Zhvillimi i partneriteteve dhe përfshirja e komunitetit

Masa 3.1: Nënshkrimi i marrëveshjeve me OJF, biznese dhe institucione arsimore

Aktivitetet:

- ✓ A 3.1.1: Identifikimi i aktorëve potencialë lokalë për bashkëpunim
- ✓ A 3.1.2: Negocimi dhe nënshkrimi i të paktën 5 marrëveshjeve bashkëpunimi

Tregues:

- 5 marrëveshje të nënshkruara me aktorë lokalë çdo vit

Masa 3.2: Organizimi i konsultimeve publike dhe aplikimi i projekteve të përbashkëta

Aktivitetet:

- ✓ A 3.2.1: Mbajtja e 2 konsultimeve publike në vit me komunitetin
- ✓ A 3.2.2: Aplikimi i të paktën 2 projekteve të përbashkëta me partnerë çdo vit
- ✓ A 3.2.3 Zbatimi i projektit "Qendër Komunitare Shumëdisiplinore" në partneritet me MSHMS dhe Fondin Social

Tregues:

- 2 konsultime publike të mbajtura në vit
- 2 projekte të dorëzuara çdo vit me partnerë lokalë
- Qendra funksionale 2024–2027, 100 individë të përfshirë çdo vit

Masa 3.3: Zbatimi i projekteve mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm në bashkëpunim me OJF ndërkombëtare

Aktivitetet

- ✓ A 3.3.3 Zbatimi i projektit ECO-PATH me CNVP Foundation

Tregues:

- 2 fshatra të përfshirë, 50 qytetarë të trajnuar çdo vit.

VIII. Plani i Veprimit

Prioriteti 1: Zhvillimi i shërbimeve sociale bazuar në nevojat e grupeve vulnerabël						
Objekti specifik		Afati i zbatimit		Financi mi dhe Burimi i financimit		Institucionet përgjegjëse
Masa	Aktiviteti	Indikator	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse
						Drejtoria /Sektori/ Departamenti (Udhëheqës)
						Institucioni kontraktues (nese ka)
Objekti 1.1: Të garantohen shërbime sociale bazike dhe të specializuara për grupet vulnerabël në të gjithë territorin.						
Masa 1.1: Ngrija e një qendre multifunkionale për familjet, fëmijët dhe individët në nevojë	A1.1.1 Realizimi i vlerësimit të nevojave	1 dokument i vlerësimit të nevojave hartuar dhe miratuar				
	A1.1.2 Sigurimi i hapësirës dhe pajisjeve	1 hapësirë funksionale me të paktën 3 dhoma shërbimi				
	A1.1.3 Emërimi i stafit	3 anëtarë staf të rekrutuar për qendrën				
	A1.1.4 Hartimi i programit të qendrës	1 program vjetor i zbatuar me të paktën 10 aktivitete komunitare				
	A1.1.5 Ofrimi i shërbimeve shoqërore	Qendra funksionale ofron shërbime				
Masa 1.2: Zhvillimi i shërbimit lëvizës për të moshuarit dhe	A1.2.1: Hartimi i modelit të funksionimit të shërbimit lëvizës.	1 model funksional i dokumentuar				

PAK	A1.2.2: Përgjethja e përfuturës në bashkëpunim me njësitë administrative.	Të paktën 30 përfuturës të identifikuar dhe të asistuar					
	A1.2.3: Trajnimi i stafit për ofrimin e shërbimeve në terren.	5 staf të trajnuar për shërbime në terren					
	A1.2.4: Sigurimi i mjeteve të transportit dhe logjistikës	1 automjet dhe 10 njësi logjistike të siguruara					
Masa 1.3: Ofrimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në rrezik dhe viktimat e dhunës	A1.3.1: Zhvillimi i një pakete shërbimesh psiko-sociale për rastet në nevojë.	Të paktën 20 raste të trajtuara me shërbime psiko-sociale					
	A1.3.2: Organizimi i ndërhyrjeve në terren për menaxhimin e rasteve urgjente.	10 ndërhyrje në terren të kryera					
	A1.3.3: Bashkëpunimi me njësitë për referimin e rasteve	3 marrëveshje me qendra të specializuara					

Prioriteti 2: Përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i grupeve në nevojë			
Objektivi specifik		Afati i zbatimit	Institucionet

Masa	Aktiviteti	Indikatori	përgjegjëse			
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Burimi i financimit	
					Drejtoria/ Sektori/ Departamenti/ Udhëheqës (nese ka)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi specifik 1: Promovimi i përfshirjes sociale dhe edukimit të grupeve në nevojë						
Masa 1.1: Organizimi i aktiviteteve komunitare dhe cikleve edukative	A 1.1.1 Organizimi i të paktën 6 aktiviteteve komunitare në vit në njësitë administrative. A 1.1.2 Zhvillimi i 4 cikleve edukative për aftësitë e jetës dhe ndërgjegjësimin social	Numri i aktiviteteve komunitare të realizuara: 6 në vit Numri i cikleve edukative të realizuara: 4 në vit				
Masa 1.2: Zbatimi i projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme	A 1.2.1 Zbatimi i 2 projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme A 1.2.2 Zbatimi i projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme	Numri i projekteve të zbatuara: 2 në vit Numri i grave/vajzave të përfshira: 80 në vit				
Masa 1.3: Zbatimi i projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme	A 1.3.1 Zbatimi i 2 projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme A 1.3.2 Zbatimi i projekteve sociale për gratë dhe vajzat në situatë të rrezikshme	Numri i projekteve të zbatuara: 2 në vit Numri i grave/vajzave të përfshira: 80 në vit				
Objektivi specifik 2: Aftësimi profesional dhe mbështetja për vetëpunësim						
Masa 2.1: Aftësimi profesional dhe mbështetja për vetëpunësim	A 2.1.1 Organizimi i 3 kurseve të	Numri i kurseve të				

Organizimi i kurseve të formimit profesional	kurseve profesionale në bashkëpunim me DAR/ZVA ose qendra trajnimi.	organizuar: 3 në vit Numri i përfutësve të trajnuar: 60 individë në vit							
Masa 2.2: Mbështetje me migrante ose pajisje për vetëpunësim	A 2.2.1 Ngritja e një fondi të vogël mbështetës për vetëpunësim.	Numri i individëve të mbështetur me grante ose pajisje: 10 në vit							
	A 2.2.2 Mbështetje me pajisje për 10 individë në vit.	Numri i bizneseve të vogla të krijuara: 5 në vit							
	A 2.2.3 Zbatimi i projektit DUARARTA për ngritjen e kapaciteteve dhe vetëpunësimin e grave.	Të paktën 20 gra të përfshira në ndërmarrjen sociale çdo vit.							
Objektivi specifik 3: Nxitja e përfshirjes në zhvillimin e qëndrueshëm									
Masa 3.1: Bashkëpunim me fermerë dhe subjekte turistike	A 3.1.1 Nënshkrimi i 5 marrëveshjeve bashkëpunimi me fermerë/subjekte.	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara: 5							
	A 3.1.2 Përfshirja e grupeve në nevojë në të paktën 3 nisma ekonomike	Numri i përfutësve të përfshirë: 30 individë							
Masa 3.2: Trajnime për punë të gjelbra dhe ekonomi	A 3.2.1 Organizimi i 2 cikleve trajnimi për punësim të gjelbër dhe riciklim.	Numri i trajnimeve të realizuara: 2 në vit Numri i pjesëmarrësve në trajnim: 40 në vit							

Masa		Aktiviteti	Indikator	Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Financi mi dhe Burimi i finansim it	Institucionet përgjegjëse	Instituc ion kontrib ues (nese ka)
Prioriteti 3: Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe e partneriteteve për shërbime sociale efektive Objektivi specifik								
Objektivi specifik 1: Rritja e kapaciteteve të stafit dhe strukturave vendore								
Masa 1.1:	A 1.1.1: Zhvillimi i një moduli trajnimi për menaxhimin e rasteve sociale	1 modul trajnimi i zhvilluar						
Trajnimi i stafit për menaxhimin e rasteve dhe mbrojtjen sociale	A 1.1.2: Organizimi i 4 sesioneve trajnimi në vit për administratorët dhe stafin social	4 trajnime të organizuara në vit 40 pjesëmarrës të trajnuar çdo vit						
Objektivi specifik 2: Themelimi i mekanizmeve funksionale për mbrojtje sociale								
Masa 2.1:	A.2.1.1: Hartimi i strukturës dhe përshkrimeve të punës për anëtarët e NjVRN	1 strukturë e miratuar për NjVRN						
Funksionalizimi i NjVRN dhe ndjekja elektronike e rasteve	A.2.1.2: Trajnimi i stafit	10 anëtarë të trajnuar						

	A 2.1.3	Ndërtimi dhe funksionimi i sistemit elektronik të ndjekjes së rasteve	Sistemi funksional për 100% të rasteve të reja						
Objektivi specifik 3: Zhvillimi i partneriteteve dhe përfshirja e komunitetit									
Masa 3.1:	A 3.1.1:	Identifikimi i aktorëve potencialë lokalë për bashkëpunim	5 marrëveshje të nënshkruara me aktorë lokalë çdo vit						
	A 3.1.2:	Negocimi dhe nënshkrimi i të paktën 5 marrëveshjeve bashkëpunimi							
Masa 3.2:	A 3.2.1:	Mbajtja e 2 konsultimeve publike në vit me komunitetin	2 konsultime publike të mbajtura në vit						
	A.3.2.2:	Aplikimi i të paktën 2 projekteve të përbashkëta me partnerë çdo vit	2 projekte të dorëzuara çdo vit me partnerë lokalë						
	A 3.2.3	Zbatimi i projektit "Qendër Komunitare Shumëdisiplinore" në partneritet me MSHMS dhe Fondin Social	Qendra funksionale 2024-2027, 100 individë të përfshirë çdo vit						
Masa 3.3:	A 3.3.3	Zbatimi i projektit ECO-PATH me CNVP	2 fshatra të përfshirë, 50 qytetarë të trajnuar çdo vit.						

IX. Monitorimi dhe vlerësimi

1. Mekanizmat e monitorimit

Përgjegjës për zbatimin dhe ndjekjen e Planit Social Vendor është Drejtori i Sektorit të Shërbimeve Sociale në Bashkinë Fushë-Arrëz, i cili siguron realizimin e masave, koordinon institucionet e përfshira dhe drejton procesin e monitorimit të planit.

Në fillim të zbatimit, Sektori i Shërbimeve Sociale do të ngrijë një grup pune për monitorimin, i cili përbëhet nga:

- Punonjës të vetë sektorit social;
- Administratorët shoqërorë dhe përfaqësues të njësive administrative;
- Përfaqësues të sektorëve të tjerë bashkiakë (si financa, arsimi, zhvillimi rural, etj.);
- Përfaqësues të OJF-ve partnere dhe aktorë të tjerë lokalë, sipas fushës së ndërhyrjes.

Procesi i monitorimit mbikëqyret nga Nënkryetari i Bashkisë, i cili siguron bashkërendim ndër-institucional dhe adresimin institucional të sfidave të hasura gjatë zbatimit.

Grupi i punës për monitorimin do të mbledhet të paktën një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe do të mbledhë të dhëna nga terreni, do të analizojë progresin dhe do të evidentojë çështjet problematike. Drejtuesi i Sektorit të Shërbimeve Sociale është përgjegjës për përgatitjen e raporteve tremujore dhe raportit vjetor të monitorimit, i cili dorëzohet në dhjetor pranë Kryetarit të Bashkisë.

2. Treguesit e performancës

Treguesit e performancës janë të përcaktuar për secilin objektiv dhe masë të planit dhe shërbejnë për të matur progresin e zbatimit. Sektori i Shërbimeve Sociale do të përdorë formate standarde të raportimit, në përputhje me strukturën e planit, për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat nga terreni.

Disa nga treguesit kryesorë përfshijnë:

- Për Prioritetin 1: numri i shërbimeve të reja të ngritura; numri i përfituesve; kapaciteti i stafit të angazhuar.
- Për Prioritetin 2: numri i aktiviteteve edukative dhe komunitare; numri i të trajnuarve; numri i projekteve të zbatuara në partneritet.

- Për Prioritetin 3: numri i trajnimeve për stafin vendor; marrëveshjet e bashkëpunimit; aplikimet dhe financimet nga donatorët.

Të dhënat do të përpunohen dhe përfshihen në raportet zyrtare të monitorimit të planit, që përgatiten nga Sektori i Shërbimeve Sociale.

3. Rishikimi periodik i planit

Rishikimi i Planit realizohet çdo vit gjatë periudhës nëntor-dhjetor, në bazë të progresit të raportuar dhe konsultimeve me grupin e punës dhe aktorët lokalë. Qëllimi i këtij procesi është:

- ❖ Vlerësimi i masave të zbatuara dhe atyre që kërkojnë përmirësim;
- ❖ Përditësimi i aktiviteteve, treguesve dhe prioritetëve sipas realitetit social dhe burimeve në dispozicion;
- ❖ Identifikimi i hapave konkretë për vitin pasardhës.

Raporti vjetor i rishikimit përgatitet nga Drejtori i Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe i dorëzohet Kryetarit të Bashkisë brenda muajit dhjetor.

Në dhjetor 2028 do të përgatitet Raporti Përfundimtar i Planit 2025–2028, si bazë për hartimin e planit të ri. Procesi për Planin Social Vendor 2029–2031 do të nisë në qershor 2028 dhe do të përfundojë brenda dhjetorit 2028, për të garantuar vijimësinë e planifikimit dhe shërbimeve sociale në nivel vendor.

Konsultimi publik: Para miratimit, drafti i Planit Social Vendor do t'i nënshtrohet konsultimit publik duke u publikuar në faqen zyrtare dhe në njësitë administrative, me dëgjuesë publike dhe mbledhje komentesh me shkrim nga qytetarët (përfshirë PAK), OJF-të dhe aktorët lokalë; raporti përmbledhës i konsultimit do t'i bashkëlidhet aktit të miratimit.

X. Aneks

Aneks 1 Kuađri legjislativ

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAE

Dokumentet strategjike:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendorë;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr.10107/2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (FZ 20-1996).

Aneksi 2. Të dhëna statistikore për grupet vulnerabël

Figural: Popullsia 2022-2024 sipas Njësive Administrative

Njësia Administrative	Popullsia 2022	Popullsia 2024	Ndryshimi (%)
Fushë-Arrëz	5,020	5,304	+5.7%
Qafë-Mali	1,480	1,158	-21.8%
Blerim	1,011	1,009	-0.2%
Fierzë	1,789	1,734	-3.1%
Iballë	1,539	1,494	-2.9%

Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz 2024

Figura 2 Të dhëna më ecurinë e familjeve përfituese të NE 2022-2024 (Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz)

Kategoritë përfituese të NE	Maj 2022 Nr.	Maj 2023 Nr.	Maj 2024 Nr.
Familje përfituese të NE	358	350	289
Individë me status jetimi	-	-	-
Individë viktime të trafikimit	-	-	-
Individë viktime të dhunës	1	1	-
Prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh	-	-	-
a) trinjakë	-	-	-
b) Katënjakë	-	-	-

c) Pesë e më shumë së fëmijë të lindur njëherësh	-	-	-
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	-	-	-
Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare	-	-	-
Total	359	351	289

Figura 3: Të dhëna mbi familjet përfituese të NE në nivel Njësie administrative muaji Maj 2024 (Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz)

Njësia Administrative	Nr i familjeve përfituese të NE
Njësia Administrative Fushe-Arrez	44
Njësia Administrative Qafe-Mali	50
Njësia Administrative Blerim	45
Njësia Administrative Fierzë	77
Njësia Administrative Iballë	73

Figura 4: Grupmosha e anetareve të familjeve përfituese të NE (Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz)

Grupmosha	Numer personash
0-15 vjeç	132
16-18 vjeç	119
Mbi 67 vjeç	25

Figura 5: Familjeve përfituese të NE me situatë sociale (Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz)

Kategoritë sociale	Numer
Gra kryefamiljare	10
Familje me anetare persona me AK	30
Familje me k/familjar në moshe pensioni	25
Vajza nena	5

Totali	70
--------	----

Figura 5: Numri i anëtareve të familjes në nivel bashkie (sipas vendimit të majit 2024)
Burimi: Bashkia Fushë-Arrëz

Familje	Nr
Me 1 anëtar	4
Me 2 anëtar	34
Me 3 anëtar	54
Me 4 anëtar	78
Me 5 anëtar	64
Me 6 anëtar	34
Mbi 6 anëtar	21
Total	289

Figura 6 Perfitues të AK sipas kategorive të AK

Njësitë Administrative	Para tetraplegjike dhe	Të verbër	Invalidë	PAK të tjerë	TOTAL PAK
Fushë-Arrëz	9	6	67	48	130
Qafë Mali	2	5	20	29	56
Blerim	0	1	8	21	30
Fierzë	1	4	27	48	80
Iballë	2	1	10	43	56
Total	14	17	132	189	352

Figura 7 Perfitues të AK në vite

Viti	Numri i personave me AK
2023	352
2024	352

Figura 8 Raporti i personave me AK ndaj popullsisë për çdo Njësi Administrative

Njësitë Administrative	Nr popullsisë	TOTAL PAK	Raporti i PAK ndaj popullsisë
Fushë-Arrëz	5304	130	2.45%

Qafa Mali	1158	56	4.84%
Blerim	1009	30	2.97%
Fierzë	1734	80	4.61%
Iballë	1494	56	3.75%
Total	10699	352	

Figura 9 Perfitime per shkak te AK

Kategorite e PAK	Përfitojnë pagesë për shkak të AK	Ndihmes personal	Ndjekin arsimin e mesëm	Ndjekin arsimin e lartë
Para tetraplegjike dhe	14	14	1	
Të verbër	17	6		
Invalidë	132			
PAK të tjerë	189	50	4	
Total	352	70	5	0

Figura 10. Të dhëna sintetike për fëmijët (nivel bashkie)

Seksioni	Treguesi	Vlera	Ndarja (nëse ka)	Shënim
Demografi	Numri i fëmijëve (Census 2023)	619	-	4,878 banorë gjithsej
Arsimi	Kopshte	6	-	-
Arsimi	Fëmijë në kopshte	67	Vajza: 31; Djem: 36	-
Arsimi	Shkolla 9-vjeçare	4	-	-
Arsimi	Shkolla e mesme	1	-	-
Arsimi	Nxënës gjithsej (arsim bazë + i	437	Vajza: 209; Djem: 228	Burim arsimor vendor

	mesëm)			
Arsimi gjithëpërfshirës	Fëmijë me AK që ndjekin arsimin	7	Bazë: 2; E mesme: 5	6 banojnë në Fushë-Arrëz
Mirëqenia (NE)	Fëmijë 0-18 vjeç në familje që marrin NE	449	0-15: 350; 16-18: 99	-
Mirëqenia (NE)	Nga këta që ndjekin shkollën	251	Vajza: 131	-

Figura 11. Fëmijët që jetojnë në familje me NE, sipas Njësive Administrative

Njësia Administrative	0-15 vjeç	16-18 vjeç
Fushë-Arrëz	58	13
Qafe-Mali	56	20
Blerim	68	8
Fierzë	95	32
Iballë	73	26
Totali	350	99

Figura 12 Projekte që realizohen në Bashkinë Fushë-Arrëz

Titulli projektit	Fokusi	Kategoritë përfituese	Donatori / Programi	OJF zbatuese	Partnerit et me Bashkinë
Qendër Komunitare Shumëdisiplinore për rindërgjyrim social-ekonomik – “Së bashku për zhvillimin shoqëror dhe	Këshillim psiko-social, orientim drejt punësimit, shërbime komunitare për rindërgjyrim social-	Familje në nevojë; individë në rrezik social	Fondi Social – financiar nga MSHMS dhe Bashkia Fushë-Arrëz	Shoqata QSNNN	Po

social të Bashkisë Fushë-Arrëz" (2024-2027)	ekonomik				
DUARARTA – Ndërmarrja Sociale (2024-2027)	Formim profesional dhe mundësi punësimi në industrinë e bimëve mjekësore	Gra të marginalizuar dhe në nevojë	MSHMS	Shoqata QSNNN – Ndërmarrja Sociale "DUARARTA"	Nuk specifikohet
RurALB – Zhvillimi i turizmit Fushë-Arrëz-Bicaj-Mali i Krrabit (2024)	Promovim shtegu turistik, fuqizim komunitar dhe aktivizim ekonomik lokal	Komuniteti lokal; aktorë të turizmit	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Shoqata QSNNN	Nuk specifikohet
WOMEN HEALTH (2024)	4 Rritje e njohurisë shëndetësore dhe advokim për politika lehtësuese	Gra dhe vajza në Fushë-Arrëz dhe Pukë	SPACE sub-grants (TFL) në partneritet me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare, Destiny Center	Shoqata QSNNN	Nuk specifikohet
ECO-PATH – Korridori Ekologjik Fushë-Arrëz-Iballë (2024-2025)	Ndërgjegjësim dhe forcim komuniteti për zhvillim të qëndrueshëm	Komunitetet në korridorin Fushë-Arrëz-Iballë	CNVP Foundati on	Shoqata QSNNN	Nuk specifikohet

Figura 13 Të dhëna mbi viktimat e dhunës

Të dhëna	Njësia Administrative	Fushe-Arrëz
----------	-----------------------	-------------

Të dhëna	Njësia Administrative Fushe-Arrez		
	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
UMM			
UM			
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës	0	0	
Gra	0	0	1
Fëmijë	0	0	0
Të moshuar	0	0	0
Burra	0	0	0
Karakteristika të viktimave të dhunës mbi 18 vjeç	0	0	1
Të papunë	0	0	1
Përfutës të NE	0	0	1
Të Pastrehë	0	0	0
Total Bashkia	0	0	1